



Komuna e Prishtinës  
Municipality of Pristina

**MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT (MiM)  
I LIDHUR NË MES TË PROGRAMIT ASSET TE USAID-IT (PERKRAHJE  
ADOLESHENTEVE PAS MESIMIT TE RREGULLT)  
KOMUNËS SË PRISHTINËS DHE  
GJIMNAZIT "XHEVDET DODA"**

Ky Memorandum i Mirëkuptimit ("MiM") i lidhur në mes të Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) me lokacion në Kompleksin e shkollës Mileniumi i Tretë, rruga Isa Kastrati, Prishtinë, Komunës së Prishtinës dhe gjimnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë, të gjithë tani e tutje të referuara si "Palët". KEC është duke implementuar Programin ASSET (Përkrahje adoleshentëve pas mesimit të rregullt) i financuar nga USAID.

**Sfondi**

ASSET, Komuna e Prishtinës dhe gjimnazi "Xhevdet Doda" ndajnë një interes të përbashkët në ofrimin e hapësirave dhe aktiviteteve që do të rrisin shkathtësitë e të rinjve për punësim dhe njohuritë për karrierë.

ASSET punon me USAID-in nën Marrëveshjen Kooperative Nr. AID-167-A-17-00001, në Programin për përkrahjen e adoleshentëve pas mesimit të rregullt. ASSET-i është iniciativë pesë vjeçare e dizajnuar të zhvilloj shkathtësi për punësim dhe ndërmarrësi tek të rinjtë duke krijuar botëkuptim pozitiv për të ardhmen e tyre.

Motoja e ASSET-it është "*Përgatitja e të rinjve të Kosovës për jetë dhe punë në shekullin 21*". Për këtë qëllim, ASSET kërkon të ngrit kapacitetin e gjimnazeve për të ofruar shkathtësi relevante punësimi dhe informata për karrierë për nxënësit e tyre. Qëllimi kryesor i Programit është të përmirësoj kapacitetin institucional të Qeverisë së Kosovës në sektorin e arsimit dhe avancimin e cilësisë në arsimin e mesëm të lartë.

Aktivitetet kryesore të ASSET-it janë:

1. Themelimi i qendrave për karrierë dhe ndërmarrësi;
2. Përkrahja edukimit për karrierë dhe ndërmarrësi në shkolla;
3. Lidhja e shkollave me punëdhënës dhe komunitet

ASSET implementohet në emër të USAID-it nga Qendra për Arsim të Kosovës (KEC), në partneritet me FHI 30 dhe Crimson Capital Corp.

## Qëllimi

Qëllimi i këtij MiM-i është të paraqes në vija të trasha qëndrimin e palëve për të qenë pjesë e kësaj marrëveshjeje, ku mund të këmbehen informatat, koordinohen aktivitetet, dhe zbatohen projektet e dakorduara në bazë të këtij MiM-i.

Palët do të punojnë në partneritet për arritjen e rezultateve në vijim:

- Themelimin e “Qendrës për karrierë dhe ndërmarrësi” në gjimnazin “Xhevdet Doda”, e cila do të shfrytëzohet për aktivitete në lidhje me edukimi për karrierë dhe ndërmarrësi dhe zhvillimin e rezultateve të të nxëniet për jetër jetën dhe punën sipas Kurrikulit të Kosovës. Qendra do të ketë hapësira të pajisura me teknologji për arsim, mjete dhe materiale që do t’u mundëson nxënësve të marri pjesë në projekte praktike me qëllim të zhvillimit të shkathtësive dhe kompetencave relevante tek nxënësit. Qendra do të jetë në dispozicion të mësimdhënësve dhe nxënësve gjatë orarit mësimor dhe po ashtu do të jetë në dispozicion për aktivitete jashtë-kurrikulare në mbremje dhe në fundjavëve siç është e paraparë në Kurrikulen e Kosovës.
- Trajnimin dhe mentorimin e ekipit të shkollës në zbatimin e edukimit për karrierë, mësimin për ndërmarrësi dhe atë të bazuar në projekte siç është paraparë në Kurrikulen e Kosovës.
- Trajnimin dhe mentorimin e ekipit të shkollës në vlerësimin e rezultateve të të nxëniet të kurrikulës për jetën dhe punën.
- Themelimin e lidhjeve në mes të shkollës dhe punëdhënësve që do të rris shkathtësitë e nxënësve për punësim.
- Ofrimin e trajnimeve, materialeve dhe udhëzuesëve për mësimdhënësit dhe nxënësit e përzgjedhur për themelimin e Klubit Teknik të nxënësve i cili do të ndihmon në mirëmbajtjen dhe sigurinë e sistemeve kompjuterike dhe teknologjisë për arsim në shkollë.

## Përgjegjësitë

ASSET do të mbaj përgjegjësi për aktivitetet në vijim:

- Blerjen e pajisjeve, teknologjisë për arsim dhe materialeve për Qendren për karrierë dhe ndërmarrësi;
- Ofrimin e përkrahjes së ekspertëve në rregullimin dhe pajisjen e Qendres për karrierë dhe ndërmarrësi;
- Ofrimin e ngjyrës dhe materialeve bazike për rregullimin e Qendres për karrierë dhe ndërmarrësi;
- Ofrimin e programeve për ngritje profesionale për mësimdhënës, të akredituara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Ofrimin e mentorëve dhe materialeve për të përkrahur mësimdhënësit dhe nxënësit në zbatimin e aktiviteteve të reja;
- Ofrimin e trajnimeve dhe materialeve mbështetëse për personelin dhe nxënësit e zgjedhur të shkollës, për t’iu mundësuar atyre themelimin e Klubit Teknik të Nxënësve, të cilët do të asistojnë në mirëmbajtjen dhe kujdesin e mjeteve kompjuterike.

Komuna do t’i ketë përgjegjësitë në vijim:

- Ofrimin e hapësirave të përshtatshme për trajnimin e mësimdhënësve gjatë fundjavave;
- Lejimin e personelit për aktivitete relevante për ngritje profesionale;

- Sigurimin e mundësive të barabarta për personelin e gjinisë femërore dhe mashkullore;
- Lejimin e qasjes së ekipit të ASSET-it, fasilituesëve dhe hulumtuesëve për të përkrahur dhe monitoruar mësimdhënësit dhe nxënësit;
- Sigurimin që hapësirat të jetë e rregulluar në mënyrë të përshtatshme dhe të mbesin në gjendje të mirë gjatë kohës sa zgjat ASSET-i;
- Sigurimin e rehatisë termale të pjesëmarrësve në aktivitetet e ASSET-it duke siguruar fonde për ngrohje gjatë muajve të dimrit;
- Ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes për përdorim të Qendres për karrierë dhe ndërmarrësi për aktivitete jashtë-kurrikulare;
- Sigurimin e fondeve për lidhje në internet dhe shpenzimet e mirëmbajtjes, përfshirë edhe ngrohjen;
- Asistimin në vëzhgimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të projektit duke bërë sondazhe dhe duke i ofruar të dhëna stafit të ASSET-it dhe njësisë së Menaxhimit të Sistemit të Informatave të Arsimit të MASHT-it; dhe
- Promovimin e themelimit të Klubit Teknik të Nxënësve brenda shkollës.

**Shkolla do t'i ketë përgjegjësitë në vijim:**

- Së bashku me ekipin e ASSET-it, të organizoj ekipin e vullnetarëve (mësimdhënësve dhe nxënësve) për të ndihmuar në rregullimin e Qendres për karrierë dhe ndërmarrësi;
- Ofrimin e inventarit basik për Qendren për karrierë dhe ndërmarrësi;
- Pajisjen e Qendres për karrierë dhe ndërmarrësi me pajisje të teknologjisë për arsim të ofruara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe ICK;
- Garantimin e sigurisë së pajisjeve të ofruara dhe garantimin e mirëmbajtjes së inventarit dhe pajisjeve;
- Me përkrahjen e ASSET-it, themelon Klubin Teknik të Nxënësve, të cilët do të asistojnë në mirëmbajtjen dhe kujdesin e mjeteve kompjuterike;
- Shfrytëzimin e pajisjeve të ofruara nga ASSET-i për organizimin e aktiviteteve që zhvillojnë aftësitë relevante të nxënësve;
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e Qendres për karrierë dhe ndërmarrësi sipas nevojës;
- Monitorimin e temperaturës dhe kushteve brenda e Qendres për karrierë dhe ndërmarrësi për të siguruar rehatinë termale të pjesëmarrësve, sidomos gjatë muajve të dimrit;
- Lejimin e qasjes së ekipit të ASSET-it, fasilituesëve dhe hulumtuesëve për të përkrahur dhe monitoruar aktivitetet e ASSET-it.

**Koordinimi i Aktiviteteve dhe Mbajtja e Komunikimit**

- Tri palët kanë përgjegjësinë për mbajtjen e komunikimit të rregullt dhe të hapur për sa i përket progresit të aktiviteteve të tyre. Ky komunikim do t'i përfshij korrespondencat me shkrim të dërguara me postë elektronike dhe fakse, dhe konferenca telefonike.
- Takime koordinuese apo bisedave telefonike do të mbahen sipas nevojës për planifikim dhe raportim mbi progresin.
- Palët do të sigurohen që informatat përkatëse të shpallen në web-faqet e tyre dhe vegëzat e web-faqeve të palëve të involvuara janë të cekura në faqet e tyre.
- Detyra dhe Përgjegjësi tjera sipas kërkesës dhe nevojës.

### **Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Ky MiM hyn në fuqi më 12 shtator, 2017 dhe mbetet në fuqi deri në fund të projektit më 6 qershor 2022. Megjithatë, ky MiM skadon automatikisht dhe konsiderohet i mbaruar në datën kur ndodh ndonjëra nga ngjarjet apo kushtet në vijim, cilado që të ndodh e para:

- a. Shpallja apo lajmërimi zyrtar i USAID-it për anulimin e ASSET-it apo veprimet e shtetit pritës që e bëjnë punën e ASSET-it jo praktike apo të pamundur.
- b. Marrëveshja e përbashkët e Palëve për ta mbaruar këtë MiM me kusht që të jepet një paralajmërim nëntëdhjetë (90) ditësh të qëllimit të mbarimit nga Pala mbaruese drejtuar Palës jo-mbaruese.
- c. Dështimi i ndonjërës Palë për të bashkëpunuar me ndonjërën nga dispozitat e këtij MiM-i.

### **Pavarësia Publike e Palëve**

Ky MiM do të zbatohet vetëm për aktivitetet që kanë të bëjnë me ASSET-in dhe vetëm për qëllimet e deklaruara në këtë MiM dhe në asnjë iniciativë të ndërmarrë aktualisht nga ndonjëra Palë bashkërisht apo ndarazi. Ky MiM nuk do të interpretohet në asnjë mënyrë si themelimi partneriteti, ndërmarrje e bashkuar apo ndonjë kombinim ose organizim tjetër legal midis Palëve. Palët do të konsiderohen si organizata të pavarura, dhe punëtorët, agjentët dhe zyrtarët e njëjës nuk do të konsiderohen si punëtorë, agjentë apo zyrtarë të palës tjetër.

### **Pronësia Intelektuale**

Çdo Pronësi Intelektuale (përfshirë, por jo edhe e kufizuar në, patentë, marka tregtare, emra të markave dhe të drejta të autorit) në pronësi të ndonjërës Palë para Datës së Hyrjes në Fuqi, ose që është zhvilluar nga një Palë përmes ndonjë aktiviteti jo të rregulluar me këtë MiM, do të mbetet pronësi e patjetërsueshme e atij subjekti. Asgjë e përfshirë në këtë MiM dhe që ka të bëjë me aktivitetet e përbashkëta të referuara më lart, me leje të veçantë, nënkuptim, ndalim apo diç tjetër, nuk do t'i kaloj asnjërës Palë ndonjë të drejtë, tapi, interes, apo licencë në zbulime, patentë, të drejta të autorit, të dhëna teknike, softuerë kompjuterik, apo dokumentacione softuerike të Palës tjetër.

- a. Informata së pari e zhvilluar, apo e kthyer në formë të shkruar apo formë tjetër, gjatë zbatimit të këtij MiM-i do të mbetet në pronësi të organizatës e cila e ka përpunuar e para, dhe Pala tjetër nuk lejohet ta publikoj apo përpunoj si pjesë të ndonjë teze, shkrimi, ligjërate publike, aplikim patente apo ngjashëm, pa pajtimin specifik nga Pala pronare. Secila Palë i jep Palës tjetër leje të veçantë me shkrim për përshkrimin e aktiviteteve të planifikuara të Palëve për qëllime informative pa restriksion.
- b. Me skadimin apo përfundimin e këtij MiM-i secila Palë do t'ia dorëzoj te gjitha materialet e këtylla konfidenciale në pronësi të saj pronarit të materialeve dhe asnjë e drejtë e shfrytëzimit të materialeve të zhvilluara nga Pala tjetër nuk do të lejohet pas skadimit apo përfundimit të këtij MiM-i.

## **Shpenzimet**

Është arrit mirëkuptimi dhe pajtimi se ASSET-i, Komuna e Prishtinës, dhe gjimnazi “Xhevdet Dpda” ndaras do t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet e bëra me përgjegjësitë e tyre përkatëse të përcaktuara në këtë MiM; prandaj, ASSET-i do të mbaj përgjegjësinë vetëm për shpenzimet e bëra nga ajo gjatë kryerjes së përgjegjësive të ASSET-it-it dhe Komuna e Prishtinës do të mbaj përgjegjësinë vetëm për shpenzimet e bëra nga ajo gjatë kryerjes së përgjegjësive të komunës dhe shkollës. As ASSET, as Komuna e Prishtinës e as gjimnazi “Xhevdet Doda” nuk do të mbuloj shpenzimet tjera apo marr përsipër obligime tjera monetare të përcaktuara me këtë paragraf të MiM-it. Në asnjë mënyrë ky MiM, nuk do të konsiderohet, kuptohet apo interpretohet si kërkesë ndaj ASSET-it qoftë nga ana e ndonjë Palë për të bërë kontribute, donacione apo pagesa direkte apo në mbështetje të programit të ASSET dhe/apo çdo aktiviteti apo ngjarje tjetër.

## **Kompensimet**

Çdo Palë do ta mbroj, kompensoj dhe ruaj Palën tjetër, zyrtarët, agjentët dhe punëtorët e saj të pa dëmtuar nga dhe kundër ndonjë detyrimi humbjeje, shpenzimi (përfshirë edhe tarifatat e arsyeshme të avokatit\*) apo kërkesave për lëndime apo dëmtime të dala nga kryerja e punëve të kësaj marrëveshjeje deri në atë shkallë që ky detyrim, humbje, shpenzim, tarifë e avokatit\*, apo kërkesë për lëndime apo dëmtime janë shkaktuar nga apo rezultojnë nga neglizhenca apo veprime të qëllimshme apo shkelje me paramendim të vetes, zyrtarëve, agjentëve apo punëtorëve të saj.

## **Njoftime**

Çdo njoftim apo komunikim tjetër formal i dhënë me këtë MiM do t'i dorëzohet në dorë apo dërgohet me postë të parapaguar apo të regjistruar Palës në adresën në vijim për atë Palë apo një adresë tjetër që Pala në një periudhë kohe të ketë caktuar me njoftim me shkrim Palës tjetër. Të gjitha kontaktet që mund të kërkohen nga Palët për zbatimin e kushteve të këtij MiM-i do të drejtohen dhe kanalizohen përmes personit specifik të caktuar si përfaqësues i çdo njëres Palë. Çdo Palë e këtij MiM-i duhet ta emëroj përfaqësuesin e saj. Këto emërime duhet të mbahen aktuale gjatë periudhës së këtij MiM-i, dhe emërimet mund të ndryshohen me komunikim direkt në pajtim me këtë paragraf.

## **Kushtet Tjera**

Ky MiM përbën tërësinë e mirëkuptimit të palëve në lidhje me këtë çështje të këtij subjekti dhe zëvendëson të gjitha mirëkuptimet dhe angazhimet e mëparshme qofshin ato me gojë apo me shkrim, midis Palëve në lidhje me këtë çështje të këtij subjekti.

Ky MiM mund të ndryshohet ose modifikohet vetëm me shkrim dhe nënshkrimin e përfaqësuesit zyrtar të të dyja Palëve.

Ky MiM do të interpretohet, administrohet dhe kuptohet në përputhje me ligjet e shtetit të Delaware-it.

Asnjëra Palë nuk do të ketë detyrime ndaj Palës tjetër për asnjë dëmtim të tërthortë, special apo të rastësishëm në lidhje me këtë MiM, edhe në qoftë se i është ofruar këshillë për mundësinë e një dëmi të tillë.